



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 132, datë 07.12.2010

PËR

MIRATIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR “GRANT THORNTON ALBANIA” SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2010, NË SHOQËRINË E SIGURIMIT “INSIG” SH.A, Grupi (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 11, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 71, të Ligjit nr. 9267, datë 29.03.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe Rregullores “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit” (të ndryshuar), me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë “Grant Thornton Albania” sh.p.k, si Ekspert Kontabël të Autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2010, të shoqërisë së sigurimit “INSIG” sh.a, Grupi (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni).
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI